Viti dymijetrembëdhjetë, më datë njëzet të muajit qershor në Firenze, sheshi G. Savonarola n.10.

Përpara meje dr. GABRIELE CARRESI, noter në Borgo San Lorenzo, i regjistruar në Dhomën e Noterëve në Firenze, Pistoia dhe Prato, janë të pranishëm zotërinjtë dhe shoqëria:

- MARINI STEFANO, i lindur në Firenze në 2 prill 1961, rezident në Firenze, rruga Di Scandicci nr.363/a, c.f. MRN SFN 61DO2 D612V, i cili është i pranishëm në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Administrativ dhe përfaqësues ligjor i shoqërisë së themeluar në date 7 tetor 1997, e quajtur:

“SIME.TEL SRL” me seli ligjore në FIRENCE, sheshi Fra Girolamo Savonarola n.10, e regjistruar në REA me nr.49283, NIPT dhe kod fiskal n. 04853080481, me kapital shoqëror të paguar në euro 91.800,00 (nëntëdhjetënjëmijëetëtetëqind presje zero zero) i autorizuar nga statuti i shoqërisë dhe vendimi i Këshillit të Administrimit, i datës 19 qershor 2013;

- FONTANA FRANCESCA, e lindur në Firenze në 2 qershor 1967, rezidente në Carmignano (Prato) rruga Lombarda n.4, kod fiskal FNT FNC 67H42D612J;

- ANTOLINI RENATO, i lindur në Firenze në 24 qershor 1946, rezident në rrugën Castelfidardo.33, kod fiskal NTL RNT 46H24 D612K;

- D'AMICO VINCENZO, i lindur në Belvedere Marittimo ne 13 prill 1963, rezident në Fiesole, rruga XXV Aprile n.17, kod fiskal DMC VCN 63D23 A&&3Y, i regjistruar në Regjistrin e Revizorëve ligjorë në n. 21394 G.U 31 i datës 12.04.1995.

Të pranishmit, qytetarë italianë dhe shoqëri italiane, për identitetin e së cilëve, unë Noteri jam i sigurt, më kërkojnë të pranoj këtë akt, për të cilin ata bien dakord dhe si më poshtë:



NENI 1) Është themeluar midis shoqërisë "SIME.TEL SRI" dhe zotërinjve Fontana Francesco, Marini Stefano e Antolini Renato një shoqëri aksionere e quajtur:

"SIME telecomunicazioni- SHOQËRI AKSIONERE"

NENI 2) Selia e shoqërisë është në Bashkinë e Firences.

Për regjistrimin në Regjistrin e Biznësit, adresa e saktë është si më poshtë: sheshi Fra Girolamo Savonarola n.10-50132 Firenze.

NENI 3) Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur deri në 31 dhjetor 2050 (dymijëepesëdhjetë).

NENI 4) Vitet ushtrimore mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Viti i parë ushtrimor mbyllet në 31 dhjetor 2013 (dymijëetrembëdhjetë).

NENI 5) Shoqëria ka si objekt shoqëror atë që parashikohet në nenin 4 të statutit të shoqërisë.

NENI 6) Shoqëria përsa i përket objektit shoqëror, administrimit, kolegjit të revizorëve, asamblesë, bilanceve, kritereve të ndarjes së fitimit dhe çdo gjë tjetër që parashikohet nga legjislacioni, rregullohet nga Statuti. Pas leximit që unë noter, u bëra të pranishmëve, Statuti i bashkangjitet këtij akti në shkronjën "A", si pjesë e pandarë dhe thelbësore.

NENI 7) Kapitali shoqëror është 130.00,00 euro (njëqindetridhjetëmijë presje zero zero) i përfaqësuar nga 1.300 (njëmijëetreqind) aksione me vlerë nominale 100,00 (njëqind presje zero zero) secili, i cili pranohet dhe nënshkruhet nga ortakët si vijon:

- SIME. TEL SRL" titullar i n.390 (treqindenëntëdhjetë) aksione për 39.000,00 (tridhjetenëntëmijë presje zero zero) barabar me 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit shoqëror, të paguar me shumën e 9.750,00 (nëntëmijëe shtatëqindpesëdhjetë presje zero zero);

- FONTANA FRANCESCA, titullar i n.390 (treqindenëntëdhjetë) aksione për 39.000,00 (tridhjetenëntëmijë presje zero zero) barabar me 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit shoqëror, të paguar me shumën e 9.750,00 (nëntëmijëe shtatëqindpesëdhjetë presje zero zero);

- MARINI STEFANO, titullar i n.468 (katërqindegjashtëdhjetëetë) aksione për 46.800,00 (dyzetegjashtëmijë presje zero zero) barabar me 36%



(tridhjetegjashte për qind) të kapitalit shoqëror, të paguar me shumën e 11.700,00 (njembedhjetemijeeshhtateqind presje zero zero)

- ANTOLINI RENATO, titullar i n.52 (pesëdhjetëedy) aksione për 5.200,00 (pesemijeedyqind presje zero zero) barabar me 4% (katër për qind) të kapitalit shoqëror, të paguar me shumën e 1.300,00 (njemijëetreqind presje zero zero)

Përsa i përket kuotave, të pranishmit deklarojnë që është bërë pagesa në para e 25% të kapitalit (njëzetepesë për qind) barabar me 32.500,00 (tridhjetëdymijëepesëqind presje zero zero), siç rezulton nga fatura e arkëtimit lëshuar nga BANKA CR FIRENZE FILIALE di Capalle në datë 18 qershor 2013. Kopja e kësaj fature e noterizuar nga unë Noteri në ditën e djeshme me Rep. 292.592 i bashkangjitet këtij akti nën shkronjën "B".

Pjesa e mbetur prej 75% (shtatëdhjetëepesë për qind) e kapitalit shoqëror do të derdhet në arkën e shoqërisë me kërkesë të organit administrativ brenda datës 31 dhjetor 2013, siç më deklarojnë të pranishmit.

Kapitali shoqëror prej 130.000,00 eurosh (njëqindmijëetridhjetë presje zero zero) rezulton i derdhur me shumën 32.500,00 (tridhjetëdymijëepesëqind presje zero zero)

Neni 8) Të pranishmit deklarojnë se shoqëria do të administrohet nga një **KËSHILL ADMINISTRIMI**, me një kohëzgjatje prej tre vitesh ushtrimorë dhe saktësisht deri në miratimin e bilancit të 31 dhjetorit 2015 (dymijëepesembëdhjetë).



STATUTI I "SIME TELECOMUNICAZIONI – SHOQËRI AKSIONERE"

Neni 1

EMËRTIMI – SELIA – AKTIVITETI – KOHËZGJATJA

U themelua shoqëria aksionere, me emërtim "SIME Telecomunicazioni Shoqëri aksionere".

Neni 2

Shoqëria ka seli në Bashkinë e Firences (FI) në adresën që i përket regjistrimit të bërë te Regjistri i biznesit, në bazë të nenit 111-ter të dispozitave zbatuese të Kodit Civil.

Neni 3

Vendbanimet e ortakëve, për atë çka i përket raporteve me shoqërine, janë ato që rezultojnë te regjistri i Anëtarëve.

Neni 4

Shoqëria (pa iu drejtuar tregut të kapitalit të riskut) ka për objekt në Itali apo jashtë saj, në respekt të legjislacionit në fuqi, aktivitetet e mëposhtme:

- Studimin, projektimin, prodhimin dhe ndërtimin, montimin dhe mirëmbajtjen e:

impianteve elektrikë, telefonikë, radiotelefonikë, televizivë, elektronikë, automatikë, specialë. Shoqëria ka si objekt edhe ofrimin e shërbimeve teknike të specializuara, ku përfshihet mirëmbajtja, riparimi i impianteve dhe furnizimi i materialeve të lidhura direkt me kompani të sektorit të telekomunikimeve, edhe përmes qiramarrjes ose formave të ngjashme;

- Marrjen e përfaqësive, kontratave, tregtimin si me pakicë ashtu edhe me shumicë të produkteve dhe shërbimeve telematike, transmetimit të të dhënave, elektrike, automatizimit; marrjen dhe ndjekjen e punëve të mirëmbajtjes të impianteve, pajisjeve, furnizimit të shërbimit telefonik, elektrik telematik të çfarëdolloj ndërmarrje private, administratë apo ente, duke përfshirë edhe

administratën shtetërore dhe entet publike përmes promovimit dhe/ose pjesëmarrjes në forma shoqërie, kontrata shoqërisht, si me karakter të përkohshëm ashtu dhe me kohë të pacaktuar;

- Furnizimin e shërbimeve si:
- kushte më të mira furnizimi për materiale dhe mallra, projektim dhe asistencë teknike;
- tregtim dhe qiramarrje e produkteve elektrike, telefonike, elektronike, telematike hardware dhe software, trafik telefonie dhe shërbime komunikimi për të tretët edhe përmes krijimit të pikave të shitjes;
- kërkim tregu;
- eksperimentim dhe inovacion për procese dhe produkte të reja;
- formim, kualifikim dhe rikualifikim profesional;
- çdo lloj aktiviteti tjetër analog ose të lidhur me sektorët ekonomikë të sipërpërmendur.

Për përmbushjen e qëllimeve të mësipërme, kompania mund të marrë masa për:

1. blerjen dhe marrjen me qira të terreneve ose magazinave, makinerive, automjeteve, pajisjeve dhe instrumentave të punës;
2. blerjen dhe shpërndarjen e materialeve duke marrë masa për ngritjen dhe administrimin e magazinave që mund të jenë të nevojshme;
3. marrjen pjesë në procese tenderimi të shtetit, të enteve publike e private për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e impianteve telefonikë, elektrikë dhe telematikë;
4. të blejë e të shesë pasuri të tundshme dhe të patundshme të nevojshme për përmbushjen e aktivitetit të shoqërisë.

Shoqëria mund edhe të kryejë aktivitete të: studimit, projektimit, ndërtimit, montimit, mirëmbajtjen e impianteve termikë të ventilimit, të kondicionimit, higjienikë, hidrosanitarë, impiante kundragazit, impiante civile, ushtarake dhe industriale në përgjithësi, panele elektrike me tension të ulët e të mesëm, kabina transformatorësh, panele drejtimi, ruajtje, kontroll i zdrukthtarive metalike,



impiante për prodhimin e energjisë për centrale termike, për impiante elektrike, për centrale, linja me tension të ulët e të mesëm, impiante të jashtme ndriçimi dhe aparate të ndryshëm.

Furnizimi në vend i izolimeve teknike, akustike, antizjarr.

Shoqëria mund të realizojë çfarëdolloj veprimi me karakter të tundshëm e të patundshëm, tregtar, industrial dhe financiar që e konsideron instrument të nevojshëm për arritjen e qëllimit social, ku përfshihet edhe përfshirja dhe pjesëmarrja me aksione në shoqëri apo kompani të tjera që zhvillojnë aktivitete të ngjashme, ose të lidhura ose plotësuese me të, në respektim të ligjit.

Shoqëria, gjithmonë me këtë qëllim mund të kryejë financime ose të ofrojë garanci, duke përfshirë kolateralin, apo të japë mbështetje në favor të palëve të treta. Sidoqoftë përjashtohet çdo aktivitet që me ligjet në fuqi i rezervohet vetëm disa subjekteve.

Neni 5

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen deri më 31 (tridhjetenjë) dhjetor 2050. (dymijëepesëdhjetë) përveçse nëse zgjatet apo shpërbëhet parakohe në përputhje me ligjin.

Neni 6

KAPITALI SOCIAL- AKSIONET- TËRHEQJA- FINANCIMET E ORTAKËVE

Kapitali shoqëror është 130.00,00 euro (njëqindetridhjetëmijë presje zero zero) i përfaqësuar nga 1.300 (njëmijëetreqind) aksione me vlerë nominale 100,00 (njëqind presje zero zero) secili.

Aksionet u japin aksionerëve të drejta të barabarta.

Aksionet përfaqësohen nga tituj aksionesh unitare.

Aksionet janë nominale.

Kontributet e anëtarëve mund të realizohen në para, natyrë dhe kredi.

Aksione nuk mund të jenë ofrimi i punës ose shërbimeve.

Neni 7

Secilit ortak i janë caktuar aksione proporcionalisht me pjesën e kapitalit shoqëror të nënshkruar dhe për një vlerë jo më të lartë se ajo që u përket.

Të drejtat në shoqëri u përkasin ortakëve proporcionalisht me pjesëmarrjen në aksione.

Neni 8

Çdo aksion ka të drejtën e një vote.

Neni 9

Aksionet janë të transmetueshëm midis të gjallëve dhe për vazhdimësi për shkak të vdekjes. Aksionet qarkullojnë në përputhje me ligjin.

Për rastin e aksioneve nominale, parashikohet e drejta e mëposhtme e parablerjes, siç konfirmohet në mënyrën e përcaktuar me ligj:

Ortaku që dëshiron të shesë aksionet e veta, duhet të informojë- duke specifikuar çmimin dhe kushtet e tjera të tjetërsimit – Organin Administrativ, me letër rekomande, - dhe ortakët e tjerë gjithmonë me letër rekomande, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Ortakët e tjerë mund të bëhen blerës të aksioneve të ofruara, në përpjesëtim me aksionet që mbajnë aktualisht.

Brenda tridhjetë ditësh nga dita në të cilën bëhet komunikimi, aksionerët duhet t'i komunikojnë Organit Administrativ me letër rekomande dëshirën e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes.

Pas skadimit të këtij afati , ata do të konsiderohen të shfuziquar nga ushtrimi i kësaj të drejte.

Aksionerët që kanë ushtruar të drejtën, do të procedojnë proporcionalisht me njëri-tjetrin për të blerë aksionet e ofruara për shitje. Në rast se ekziston vetëm një aksionar që dëshiron ta ushtrojë këtë të drejtë, ky i fundit mund të bëhet blerësi i të gjithë paketës së aksioneve.

Ushtrimi i së drejtës së parablerjes nuk do të bëhet në rast se transferimi bëhet në favor të të afërmve në linjë të parë me transferuesin dhe as në rastin e transferimeve që synojnë krijimin ose përfundimin e mandatit të besimit.

Transferimet midis përfaqësuesit dhe shoqërisë bëhen kur shoqëria ekspozon regjistrin e titujve të përfaqësuesit, ku tregohet mandati dhe pranohet shprehimisht respektimi i rregullave ligjore në lidhje me parablerjen; është subjekt parablerje zvendësimi i përfaqësuesit ose çdo transferim i bërë nga shoqëria tek subjekte të ndryshme nga përfaqësuesi.

Neni 10

Aksioneri mund të tërhiqet nga shoqëria, për një pjesë ose për tërësinë e aksioneve të tij, në rastet e parashikuara në nenin 2347 të Kodit Civil, paragrafi 1, si dhe në rastet e tjera të parashikuara shprehimisht nga ky statut dhe nga ligji. Për termat dhe metodat e ushtrimit të tërheqjes nga shoqëria, si dhe për kriteret për përcaktimin e vlerës së aksioneve, merret si referenca legjislacioni në fuqi.

Neni 11


Kapitali aksionar mund të rritet siç parashikon legjislacioni në fuqi, me një vendim të mbledhjes së asamblesë, me anë të kontributeve të reja ose me shpërndarjen e rezervave dhe fondeve të tjera të disponueshme të regjistruara në pasqyrat financiare.

Aksionet e emetimeve të reja duhet t'u ofrohen aksionarëve në përpjesëtim me numrin e aksioneve që kanë, përveç nëse me vendim të mbledhjes së asamblesë, aksionet jepen në natyrë apo i rezervohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 2442 të Kodit Civil.

Aksionerët ushtrojnë të drejtën e opsionit, me kusht që ata të bëjnë një kërkesë të njëkohshme. Ata kanë të drejtën e parablerjes në blerjen e aksioneve që kanë mbetur të pahapura.

Neni 12

Aksionerët mund të vendosin të zvogëlojnë kapitalin, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në nenet 2327 dhe 2413 të Kodit Civil, ose të ndonjë reference tjetër ligjore, duke rimbursuar aksionarët e kapitalit ose duke i liruar ato nga detyrimi i pagesave, në zbatim të nenit 2245 të Kodit Civil.



Për rastet e zvogëlimit të kapitalit për shkak të humbjeve, do të zbatohen nenet 2446 dhe 2447 të Kodit Civil.

Neni 13

Organi administrativ mund të krijojë asete të destinuara për një biznes specifik, në përputhje me nenin 2447 dhe nenet e tjera vijuese të Kodit Civil.

Neni 14

Shoqëria mund të marrë hua nga aksionarët, me ose pa pagesë, me ose pa detyrim shlyerjeje; këto kredi, si me interesa ashtu edhe pa interesa, duhet të bëhen në përputhje me modalitetet dhe brenda kufijve të legjislacionit në fuqi. Nëse nuk është pajtuar ndryshe, shumat e paguara si hua nuk janë me interesa.

ASEMBLEJA

Neni 15

Asambleja mbledhet në Bashkinë ku është vendosur shoqëria ose diku tjetër, me kusht që të jetë në Itali. Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.

Mbledhja e aksionerëve organizohet sa herë që organi administrativ e gjykon të nevojshme ose të përshtatshme; ose kur Organit Administrativ i kërkohet ta bëjë këtë, duke treguar temat që do të diskutohen, nga shumë aksionarë që përfaqësojnë të paktën 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, siç parashikohet në paragrafin e fundit të nenit 2367 të Kodit Civil.

Në asamble mund të marrin pjesë vetëm aksionerët ose personat e pajisur me prokurë që kanë të drejtë vote dhe që kanë paraqitur certifikatat e aksioneve përkatëse brenda 5 ditëve nga data e organizimit të mbledhjes.

Neni 16

Asambleja thirret nga administratorët përmes komunikimit zyrtar ku përcaktohet dita, ora dhe vendi i mbledhjes, rendi i çështjeve për t'u diskutuar, që publikohet në revistën "La nazione" të paktën 15 ditë para ditës së organizimit të asamblesë. Deri kur shoqëria nuk do të përdorë tregun e kapitalit të riskut, asambleja mund të thirret të paktën 8 ditë para, përmes një lajmërimi, që dërgohet me postë rekomande, ose me postë elektronike të certifikuar. Në vend




të letrave rekomande mund të përdoren edhe mënyra të tjera dërgimi, me kusht që të garantojnë provën e sigurt të marrjes së komunikimit, siç është përmendur më sipër.

Në mungesë të formaliteteve të lartpërmendura, mbledhja konsiderohet e rregullt kur është i pranishëm ose i përfaqësuar i gjithë kapitali shoqëror, ose merr pjesë në asamble shumica e pjestarëve të organit administrativ dhe e kontrollit. Megjithatë, në rast se ndonjë nga pjesëmarrësit nuk e konsideron veten mjaftueshmërisht të informuar, ai mund të kundërshtojë diskutimin e temave të mbledhjes dhe rendit të ditës. Vendimet e marra në bazë të paragrafit të mëparshëm, duhet t'i komunikohen menjëherë organit të administratës dhe organit të kontrollit që nuk janë të pranishëm.

Është e pranuar mundësia e zhvillimit të mbledhjes në telekonferencë, me kusht që të respektohen metodat kolegjinale dhe parimet e mirëbesimit dhe trajtimit të barabartë të aksionarëve, prandaj, ndër të tjera:

- Të gjithë pjesëmarrësit duhet të identifikohen. Atyre u lejohej ndjekja e diskutimit dhe ndërhyrja në mbledhje në kohë reale për diskutimin e temave të rendit të ditës. Pjesëmarrësit mund të njihen paraprakisht me dokumentacionin e mbledhjes si dhe mund të trasmetojnë dokumenta;
- Kryetari i Mbledhjes së Aksionarëve duhet të lejohet të kryejë detyrën e tij për identifikimin dhe vlerësimin të legjitimitetit të të pranishmëve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit;
- T'i mundësohet sekretarit të mbledhjes të kuptojë në mënyrën e duhur punën e asamblesë, ndërhyrjet e ortakëve dhe çdo gjë tjetër që është objekt i procesverbalit të mbledhjes.

Është saktësisht e parashikuar, që nëse asambleja kryhet online, të përcaktohen në njoftimin e thirrjes, koordinatat audio/video nga ku pjesëmarrësit mund të ndërhyjnë, duke e konsideruar selinë e zhvillimit të mbledhjes në vendin, në të



cilin janë të pranishëm kryetari dhe sekretari i mbledhjes që përgatit procesverbalin.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamble, nga një ortak tjetër ose nga një i tretë, përmes një prokure të shkruar. Ky dokumentacion ruhet siç është e përshkruar në artikullin 2372 të Kodit Civil. Prokura nuk mund të lëshohet vetëm me emrin e përfaqësuesit dhe pa të dhëna të tjera. Ortaku mund të përfaqësohet vetëm nga personi që është saktësisht i përcaktuar në prokurë. Nesë prokura është vetëm për asamblenë, është e vlefshme edhe për thirrjet pasuese të saj. Përfaqësimi nuk mund t'u jepet anëtarëve të organeve administrative ose mbikëqyrëse, as punonjësve të shoqërisë, as shoqërive që kontrollohen prej saj ose nga anëtarët e organeve administrative ose mbikëqyrëse ose punonjësit e tyre.


Asambleja kryhesohet nga Administratori i Vetëm ose nga Kryetari i Organit Administrativ, ose në mungesë të tyre nga një person që zgjidhet me shumicë të thjeshtë nga pjesëmarrësit.

Kryetari asistohet nga një sekretar, përveç rasteve kur procesverbali redaktohet nga një Noter.

Vendimet e asamblesës hidhen në një procesverbal të nënshkruar nga Kryetari dhe nga sekretari ose nga noteri.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e asamblesës dhe bashkëngjitur identitetin e pjesëmarrësve dhe kapitalin që përfaqëson secili prej tyre; duhet gjithashtu të përmbajë mënyrat dhe rezultatin e votimit dhe bashkëngjitur të ketë identifikimin e ortakëve pro, kundra ose abstenues. Në procesverbal duhet të përmbliidhen, me kërkesën e anëtarëve, deklaratat e tyre në lidhje me rendin e ditës. Procesverbali i asamblesës së jashtëzakonshme duhet të redaktohet nga një Noter. Procesverbali duhet të hartohet pa vonesë, në kohë të përshtatshme për ekzekutimin e shpejtë të detyrimeve të dosjeve ose të publikimit.

Kryetari i asamblesës verifikon rregullsinë e mbledhjes, sigurohet për identitetin dhe legjitimitimin e të pranishmëve, rregullon zhvillimin e mbledhjes dhe



sigurohet për rezultatet e votimeve; rezultatet e votimeve duhet të paraqiten në procesverbal.

Neni 17

Asambleja e zakonshme dhe e jashtëzakonshme vendos mbi çështjet të përcaktuara me ligj.

Neni 18

Asambleja e zakonshme:

- në thirrjen e parë dhe të dytë: është e rregullt kur ka të pranishëm të paktën 60% të kapitalit shoqëror dhe vendoset me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 60% të kapitalit shoqëror.

Asambleja e jashtëzakonshme:

- në thirrjen e parë: është e mbledhur rregullisht dhe vendos me votën pro të shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën 60% të kapitalit shoqëror;
- në thirrjen e dytë: është e vlefshme me pjesëmarrjen e shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën 60% (gjashtëdhjetë për qind) të kapitalit shoqëror dhe vendoset me votën pro të shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën 60% (gjashtëdhjetë për qind) të kapitalit shoqëror.

Megjithatë, pa cënuar kuorumet e ndryshme të përcaktuara në mënyrë të detyrueshme me ligj; veçanërisht për miratimin e bilancit, emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve, aplikohen kuorumet e parashikuar nga ligji.

ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Neni 19

Shoqëria administrohet, ose nga një administrator i vetëm ose nga një Këshill administrimi I formuar nga 2 (dy) deri në 7 (shtatë) këshilltarë.

Neni 20

Administratorët që mund të jenë edhe jashtë ortakërisë, zgjasin në detyrë për një periudhe jo më të gjatë se tre vite ushtrimorë deri në datën e thirrjes së asamblesë për miratimin e bilancit që i përket vitit ushtrimor të fundit të qëndrimit të tyre në detyrë;

Edhe pse emërohen nga akti themelimit, mund të rizgjidhen dhe të revokohen me një vendim asambleje në çfarëdo lloj kohe, duke pasur të drejtën e zhdëmtimit të dëmit, nëse revokimi vjen pa arsye të drejtë.

Neni 21

Administratorëve u takon, përveç rimbursimit të shpenzimeve të bëra për arsye pune, edhe një rrogë vjetore, që mund të formohet tërësisht ose pjesërisht nga ndarja e fitimit- e vendosur gjatë aktit të emërimit ose gjatë asamblesë; në fund të mandatit të tyre mund të llogariten edhe shumat të quajtura trajtim për fund mandati ose mënyra të tjera shpërblimi të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 22

Organit administrativ, si Administratorit të Vetëm ashtu edhe Këshillit të Administrimit, u janë dhënë kompetenca më të gjera për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe në përgjithësi për administrimin e ndërmarrjes, për përmbushjen e gjithë veprimeve të nevojshme për realizimin e objektit shoqëror, me përjashtimet e parashikuara në ligj, ose që ky dokument ia ka rezervuar kompetencës së asamblesë së ortakëve.

Neni 23

Këshilli i Administrimit zgjedh Kryetarin, nëse ky nuk është emëruar nga asambleja dhe eventualisht edhe nënkryetarin.

Neni 24

Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të miratohen me mënyrë kolegjiale. Këshilli mbledhet pranë selisë zyrtare, ose në çfarëdoq vendi tjetër në Itali, çdo herë që Kryetari e konsideron të nevojshme ose i kërkohet prej ndonjë Këshilltari.

Thirrja për mbledhje duhet t'u dërgohet këshilltarëve përmes:

- Një letre rekomande ose telegrami të dërguar pranë banesës të secilit administrator (ose revizorit të emëruar) të paktën pesë ditë para mbledhjes, ose



- Me telefax ose postë elektronike të dërguar çdo administrator (ose revizorit të emëruar) të paktën pesë ditë para mbledhjes, respektivisht tek numri i faxit, ose postës elektronike të deklaruar pranë shoqërisë.

Njoftimi duhet të përmbajë datën, orën, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës. Në raste urgjence, afati mund të afrohet me një ditë dhe njoftimi do të dërgohet me telegram ose telefax.

Në mungesë të njoftimit të rregullt, mbledhja është njësoj e vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë këshilltarët në detyrë dhe pjesëtarët e Kolegjit të Revizorëve. Këshilli i Administrimit është i vlefshëm me praninë e shumicës absolute të administratorëve në detyrë dhe vendimet janë të vlefshme me votën pro të shumicës absolute të të pranishmëve, me përjashtim shumicës së parashikuar me ligj.

Vota nuk jepet me përfaqësim ose me korrespondencë.


Procesverbali është nënshkruar nga Kryetari ose nga Sekretari, i cili mund të jetë dhe i huaj për Këshillin.

Është e pranuar mundësia që mbledhjet e Këshillit të Administrimit të mbahen në tele-videokonferenca, me kusht që pjesëmarrësit të jenë saktësisht të indentifikuar nga të tjerët, si edhe t'u mundësohet pjesëmarrja në diskutim dhe ndërhyrja gjatë diskutimit të argumentave, si edhe t'u bëhet e mundur marrja dhe transmetimi i dokumentave. Me plotësimin e këtyre kërkesave, Këshilli i Administrimit quhet i mbajtur në vendin, në të cilin janë të pranishëm Kryetari dhe sekretari i mbledhjes që harton dhe përgatit procesverbalin.

Neni 25

Këshilli i administrimit mund të emërojë nga anëtarët e vet, një ose më shumë administratorë të deleguar ose një komitet ekzekutiv, duke saktësuar atributet dhe pagesën. Nuk janë të delegueshme zërat e listuar në artikullin 2387, pika 4, e Kodit Civil.

Një ose më shumë anëtarëve të këshillit adminstrativ mund t'i delegohen, në mënyrë eskuzive, funksionet që i përkasin detyrimeve normative, taksative,



fiskale kontribuese, sigurisë dhe higjienës në punë dhe të gjitha detyrimet në lidhje me subjektet që marrin të ardhura për punën e pavarur nga shoqëria, si p.sh. të ardhura për punën autonome dhe të ardhura nga kapitali; personit që i atribuohen funksionet e sipërpërmendura i takon të ushtrojë, gjithmonë në mënyrë eskuzvie, të gjithë kompetencat e vendimmarrjes dhe të mbajë raportet me Autoritetet dhe Zyrat kompetente për trajtimin e këtyre problematikave ose, për të njëjtat çështje me Autoritetet Gjyqësore të çdo niveli apo shkalle.

Këshilli i administrimit mund të emërojë drejtorë apo të deleguar special.

Në respektim të nenit 2381 të Kodit Civil; afati për informim në pikën pesë të nenit 2381 është saktësisht i përcaktuar në periudhën e të paktën 150 (njëqindpesedhjetë) ditëve.

Neni 26

Përfaqësimi i shoqërisë, përballë të tretëve dhe në proces gjykimi i përket Administratorit të Vetëm ose Presidentit të Këshillit të Administrimit, dhe në mungesë ose në pamundësi të këtyre, i takon Zv. Presidentit, si edhe Administratorit/ve i/të Deleguar, në kufijtë që i përcakton mandati.


Organi administrativ mund të emërojë drejtorë, ndihmës e kujdestarë për akte të përcaktuara ose kategori aktesh.

Neni 27

Kur Administrimi i shoqërisë i besohet Administratorit të vetëm, ai përmbledh pranë vetes të gjitha kompetencat dhe të drejtat e Këshillit të Administrimit dhe të Presidentit të tij.

Neni 28

Asambleja nominon organin e kontrollit që mund të jetë monokratik ose kolegjal siç parashikohet në nenin 2477 të Kodit Civil (ndryshuar me nenin 14, pika 13 të L.183/2011), dhe do të ketë funksionet e kontrollit kontabël.



Organi monokratik dhe kolegjal mbikqyr me kujdes pajtueshmërinë me ligjin dhe Nenet e Statutit dhe përputhjen me parimet e administrimit të saktë. Ai mund:

- a) të bëjë akte inspektimi ose kontrolli;
- b) t'u kërkojë informacione administratorëve lidhur me ecurinë e administrimit të shoqërisë dhe çështje të caktuara;

Në rastin e emërimit të Organit Kolegjial, në rast se Statuti nuk përmban një disiplinë e shprehur për këtë çështje, për të aplikohen standartet e përmendura në nenet 2397 dhe më poshtë të Kodit Civil.

Organi Kolegjial thirret nga Kryetari me njoftim të dërguar secilit prej anëtarëve 8 (tetë) ditë më parë mbledhjes. Në rast urgjence, të paktën 3 (tre) ditë përpara. Njoftimi mund të redaktohet me çfarëdolloj mjeti ndihmës (letër ose elektronikisht) dhe mund të dërgohet me çfarëdolloj sistemi komunikimi (duke përfshirë telefaxin ose postën elektronike).

Mbledhja e Organit Kolegjial është e vlefshme dhe ka të drejtë vendimesh, edhe në mungesë të këtyre formaliteteve, nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët e organit kolegjal.

Mbledhjet e Organit Kolegjial mund të zhvillohen edhe në vende të tjera afër ose larg, në audio-video ose edhe vetëm të lidhura me audio, me kusht që të respektohen metodat kolegjiale dhe parimet e mirëbesimit dhe trajtimit të barabartë të pjesëmarrësve, prandaj, ndër të tjera:

- a) t'i mundësohet kryetarit identifikimi i qartë dhe legjitimimi i ndërhyrjeve për një zhvillim të rregullt të mbledhjes;
- b) t'u lejohet pjesëmarrësve shkëmbimi i dokumentacionit dhe pjesëmarrja në kohë reale për diskutimin e temave të rendit të ditës dhe për votimin e njëkohshëm të temave të ditës;
- c) të saktësohen në njoftimin e thirrjes koordinatat audio-video nën kujdesin e shoqërisë, në të cilin pjesëmarrësit mund të ndërhyjnë. Mbledhja konsiderohet e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari.





Neni 29

Për funksionimin dhe shpërblimin e Kolegjit Sindakal dhe për dallimin nga organi i revizorit kontabël vlen legjislacioni në fuqi.

Neni 30

Viti Ushtrimor ka fillimin në një janar dhe mbarimin në 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 31

Në përfundim të vitit ushtrimor, organi administrativ, siç parashikohet nga legjislacioni në fuqi vazhdon punën për hartimin e bilancit që duhet t'i paraqitet asamblesë për aprovim brenda 120 (njëqindenzet) ditësh nga mbyllja e vitit ushtrimor. Ekziston mundësia për të shtyrë afatin deri në 180 ditë për mbylljen e vitit ushtrimor, siç parashikohet nga neni 2364 i Kodit Civil, në kufijtë dhe kushtet e saktësuara të kësaj neni.

Neni 32

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci do të ndahen kështu:

- një shumë jo më e vogël se 5% (pesë për qind), tek rezerva ligjore siç parashikohet nga neni 2430 i Kodit Civil;
- Pjesa që mbetet, në dispozicion të ortakëve që përcaktojnë çdo vit destinacionin sipas ligjit.

Ortakët mund të arkëtojnë fitimin pranë Kasës së Shoqërisë sipas kushteve të përcaktuara nga asambleja e ortakëve që aprovon bilancin.

SHKRIRJA DHE LIKUJDIMI

NENI 33

Pas verifikimit dhe konstatimit një shkak për shkrirjen e shoqërisë, siç parashikohet në ligj, asambleja thirret për vendimet e nevojshme.

Është kompetencë e asamblesë, sipas nenit 2487 të kodit civil, në veçanti:

- a) Përcaktimi i numrit të likujduesve dhe të rregullave të funksionimit të kolegjit në rastin e shumë likujdatorëve;
- b) Emërimi i likujduesëve dhe saktësimi i atyre që u takon përfaqësimi i shoqërisë;

- c) Përcaktimi i kriterëve bazë mbi të cilat do të kryhet likuidimi;
- d) Përcaktimi i të drejtave të likuidatorëve, në veçanti përsa i përket mbylljes së shoqërisë, degëve të saj, të mirave materiale;
- e) Përcaktimi i akteve të nevojshme për ruajtjen e vlerave të ndërmarrjes, duke përfshirë edhe ushtrimin provizor, edhe të degëve, me qëllim realizimin më të mirë.

KLAUZOLA E ARBITRAZHIT

Neni 34

Çfarëdolloj mosmarrëveshje që mund të ndodhë midis ortakëve, ose midis ortakëve dhe shoqërisë dhe ka si objekt të drejta të disponueshme që i përkasin raportit shoqëror, duke përjashtuar ato që ligji parashikon si të detyrueshme ndërhyrjen e Ministrive, duhet të zgjidhet nga një arbitër i emëruar nga Kryetari i Urdhrit të Kontabilistëve të Firences, i cili duhet të marrë masa brenda 30 ditëve nga kërkesa e bërë nga pala e diligjencës.

Në rastin kur subjekti i emëruar nuk merr masa brenda afatit të përcaktuar, emërimi do t'i kërkohet Kryetarit të Gjykatës në vendin ku ka selinë shoqëria.

Selia e arbitrazhit do të jetë pranë banesës së Arbitrit.

Arbitri duhet të vendosë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga emërimi. Arbitri do të vendosë pa anësi.

Që tani, mbetet e vendosur në mënyrë të pakthyeshme që zgjidhjet dhe vendimet e arbitrit do të jenë të detyrueshme për palët.

Shpenzimet e arbitrazhit janë në ngarkim të palës humbëse, përveçse nëse vendoset ndryshe nga arbitri.

Anullimi i kësaj klauzole kompromisi mund të bëhet në çfarëdolloj momenti, me kusht që të miratohet me vendim të ortakëve me shumicë prej të paktën 60% të kapitalit shoqëror.

Përsa nuk është parashikuar, aplikohen dispozitat e Dekretit Legjislativ të 17 janarit 2003 n. 5.



SHOQËRI NË KRIJIM- FATURA E ARKËTIMIT TË KAPITALIT SHOQËROR

Depozita n. 00383 – 1000- 600009

Në lidhje me depozitën e sipërpërmendur për themelimin e kompanisë

Emërtimi/ emri i biznesit	SIME TELECOMUNICAZIONI SPA
Selia Ligjore	FIRENZE- PIAZZA SAVONAROLA 10
Aktiviteti	INSTALIM, MIRËMBJATJE E RRJETEVE TELEFONIKE
Kapitali shoqëror në para	32.500,00 (tridhjetedymijepeseqind/00) euro

Dëshmohet se subjekti i mëposhtëm:

Mbiemri	ANTOLINI		
Emri	RENATO		
Kombësia	ITALIANE	Seksi (M/F)	M
Vendi i lindjes	FIRENCE	Provinca	FI
Data e lindjes	24/06/1946	Kodi Fiskal	NLTRNT46H24D612K
Rezidenca	FIRENCE- RRUGA CASTELFIDARDO 33		
Vendbanimi (nëse është i ndryshëm nga rezidenca)			
Dokumenti i identitetit	KARTA E IDENTITETIT	N. AT9662350	
Lëshuar nga	BASHKIA FIRENCE	Data e Lëshimit 21/08/2012	
XX për llogari të vet	<input type="checkbox"/> për llogari të personit juridik të sipërpërmendur		
Selia Ligjore			
NIPTI		Kodi fiskal	

Ka/ kanë derdhur sot pranë arkës sonë, në zbatim dhe për qëllim të nenit

- X 2342 (për themelimin e shoqërisë aksionere)
- 2454 (për themelimin e shoqërisë me ortakëri të kufizuar aksionere)
- 2454 (për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar)

Është derdhur shuma prej 32.500,00 korresponduese e 25% të kapitalit në para, për llogari të nënshkruesit.



SHTYRJA

Neni 36

Përsa nuk është specifikisht e parashikuar në këtë statut, janë të vlefshme dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacioni specifik për shoqëritë aksionere.

Firmosur nga Stefano Marini – Francesca Fontana – Renato Antolini – Vincenzo D’Amico – Gabriele Carresi Noter

KOPIA ËSHTË E NJËJTË ME ORIGINALIN

(VULA E NOTERIT)



Emër mbiemër, ose Emri I biznesit	Vendi, data e lindjes, qyteti	Kodi fiskal	Rezidenca ose Selia ligjore	Pjesëmarrja e Kapitalit shoqëror të derdhur (*)
MARINI STEFANI	FIRENCE 02/04/1961	MRNSFN61D02D612V	FI RRUGA D SCANDICCI 263/A	36%
SIME. TEL SRL		04853080481	FI SH. SAVONAROLA 10	30%
FONTANA FRANCESCA	FIRENCE 02/06/1967	FNTFNC67H42D612J	CARMIGNANO RRUGA LOMBARDA 4	30%
ANTOLINI RENATO	FIRENCE 24/06/1946	NTLRNT46H24D612K	FI CASTELFIFARDO	4%

(*) duhet treguar për çdo ortak, përqindja e kapitalit që përfaqësohet nga shuma e derdhur (psh derdhje 10.000 euro për një kapital shoqëror 100.000 euro tregohet me 10%.

Depozita rregullohet nga këto rregulla.

- shumat e depozituara i dorëzohen administratorëve të shoqërisë, ose subjektit që autorizohet nga akti i themelimit, përmes prodhimit të një certifikate nga regjistri i biznesit- i lëshuar në një datë të afërt, sidoqoftë jo më të vjetër se një muaj- që certifikon që shoqëria është rregjistruar dhe ka të drejta të plota të ushtrisë të drejtat e saj; nga kjo certifikatë duhet të rezultojnë edhe gjeneralitetet e administratorëve në ngarkim për përfaqësimin e shoqërisë dhe modalitetet e nënshkrimit.
- Në rast të mos realizimit të rregjistrimit të kompanisë në rregjistrin e biznesit, shumat e depozituara u kthehen nënshkruesve, kur kanë kaluar të paktën 90 ditë nga nënshkrimi i aktit të themelimit (ose nga lëshimi i autorizimeve të parashkuara në nenin 2329) përmes paraqitjes së:
 - Deklaratës nga ana e noterit ku është hartuar akti i themelimit, ku deklarohet saktësisht motivi për të cilin nuk u vijua me rregjistrimin;
 - Certifikatën e zyrës së rregjistrimit të biznesit- i lëshuar në një datë të afërt, sidoqoftë jo më të vjetër se një muaj, por pas skadimit të 90 ditëve- ku certifikohet rregjistrimi i munguar i shoqërisë në këtë regjistër.
- Në të gjitha hipotezat e parashkuara më sipër, duhet të rikthehet mandati origjinal i lëshuar nga Banka ose një ekstrakt i noterizuar i aktit të themelimit, ku fatura rezulton e bashkangjitur në këtë akt
- Në rast humbje apo shkatërrimi të mandatit, duhet informuar direkt banka duke saktësuar ditën dhe orën kur është bërë pagesa. Personat që kanë të drejtë t'u kthehet pagesa, por s'janë në gjendje të paraqesin faturën, duhet të nënshkruajnë një deklaratë ku saktësojnë motivet (shkërrim, grisje) duke i hequr bankës përgjegjësinë për ndonjë dëm që mund të shkaktohet nga mungesa e mandatit.
- Në çdo rast duhet të prodhohet çdo dokumentacion që i provon Bankes legjitimitimin e kërkesës për rikthimin e shumës së depozituar.

Ndërkohë:

- Shumat e depozites provizore do të rregullohen me një taksë nominale bruto prej 0.01%
- Bashkë me depozitën, paguhet një komision prej 30.00 euro.

(BANKA CR FIRENCE S.P.A)

Rep. 292.592

Unë dr. Gabriele Carresi, Noter ne Borgo San Lorenzo, i regjistruar në Dhomën e Noterëve të bashkuar të Firences, Pistoias dhe Pratos, certifikoj këtë fotokopje që është e njëjtë me origjinalin, dokument që më është paraqitur nga të interesuarit dhe atyre ua kthej prapë.____

Firence, njëzetënjë qershor dymijëetrembedhjetë, sheshi Savonarola 10

(VULA E NOTERIT)

KOPJE E NJËJTË ME ORIGJINALIN



Përbërë nga: Marini Stefano e Antolini Renato

Të sipërpërmendurit, të pranishëm, pranojnë detyrat që u janë ngarkuar dhe kërkojnë në bazë të Kodit Civil, regjistrimin pranë Rregjistrimit të Biznesit. Ata deklarojnë që nuk ka shkaqe për papranueshmëri, papajtueshmëri dhe konfiskim, siç parashikohet nga Kodi Civil ose nga legjislacioni tjetër në fuqi. Delegojnë dhe presin plotësimin e dokumentacionit nga unë noteri.

Të sipërpërmendurit, të mbledhur në Këshill, emërojnë Kryetar z. Marini Stefano, i cili pranon detyrën e dhënë.

Administrimi i shoqërisë do të kontrollohet nga një kryetar i vetëm dhe revizor për kohëzgjatjen e tre viteve ushtrimore dhe saktësisht deri në aprovimin i bilancit të 31 dhjetorit 2015 (dymijëepesëmbëdhjetë) në personin e D'Amico Vincenzo, i cili pranon detyrën e dhënë dhe deklaron që nuk ekzistojnë shkaqe për papranueshmërinë.

Të pranishmit delegojnë z. Marini Stefano të tërheqë pranë Bankës së sipërpërmendur shumën e 25 % (njëzetepesë për qind) të kapitalit social, sapo të përfundojnë procedurat e themelimit ligjor të shoqërisë.

Shpenzimet për themelimin ligjor shkojnë afërsisht 4.000,00 euro (katërmijë presje zero zero).

Këshilli i Administrimit delegohet për të vijuar punën me rritjen e kapitalit shoqëror deri në 1.000.000,00 (një milion presje zero zero) euro deri në 21 dhjetor 2015 (dymijëepesëmbëdhjetë) edhe përmes kontributeve të mallrave në natyrë.

Palët më përjashtojnë nga leximi i aneksit B)

I shkruar nga një person i besuar nga unë, dokumenti është përgatitur në 5 fletë. Unë, noteri ua lexoj të pranishmëve, të cilët deklarojnë se ky akt është konform vullnetit të tyre.

I firmosur në ora dhjetë.

Firmosur nga Stefano Marini – Francesca Fontana – Renato Antolini – Vincenzo D'Amico – Gabriele Carresi Noter

KOPJE E NJËJTË ME ORIGINALIN

REGJISTRUAR NË BORGIO, SAN LORENZO NË 25 QERSHOR 2013, NR 1466

Borgio S. Lorenzo 29 MAJ 2020

(DATA, FIRMA, VILA E NOTERIT)



VËRTETIM APOSTILLE

(Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961)

1. Shteti ITALI
Ky dokument publik
2. është nënshkruar nga: Gabrielle Carresi
3. në cilësinë e: noterit
4. mban vulën e noterit në Borgo San Lorenzo

VËRTETUAR

5. në Firence
6. Më datë 12 qershor 2020
7. nga: Prefektura e Firences
8. me nr. 1474
9. Vula:

10. ASISTENTI ADMINISTRATIV
Giulia Tramonti
//NËNSHRIMI, VULA//

*Iskultures
Fareh Beslio
Beslio*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER IRMA BROCI

DATE 16/07/2020
NR REP 1439

V2020054320080434926



VËRTETIM PËRKTHIMI

Vërtetoj nënshkrimin e përkthyesit **Faruk Besho**, përkthyes zyrtar, banues në Tiranë, person fizik i njohur nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, i cili më deklaroi se ka përkthyer identikisht dokumentin e mësipërm bashkëngjitur këtu, nga gjuha italiane në atë shqipe dhe e ka nënshkruar rregullisht në praninë time.

NOTER
IRMA BROCI

